



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr _____ prot.

Tiranë më _____.____.2024

**VENDIM
Nr. 286, datë 29.05.2024
PËR**

SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË NDËRMJETËM NR.299, DATË 13.07.2021 “PËR PEZULLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS TË KANDIDATIT PËR KËSHILLTAR LIGJOR, Z. GERTI SHANI” DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË MËTEJSHME TË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90 dhe 97, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në nenin 32 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 55 dhe 56 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 68, pika 2 të Kodit të Procedurës Administrative, dhe vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve ligjore dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, me propozimin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, si dhe pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm nr. 299, datë 13.07.2021 “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit për këshilltar ligjor z. Gerti Shani” dhe vijimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin për këshilltar ligjor z. Gerti Shani, pas marrjes formë të prerë të vendimit për verifikimin nga organet e rivlerësimit.
2. Caktimin e znj. Gentiana Muçaj, relatore të kësaj procedure.
3. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet z. Gerti Shani.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar që do të merret nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përfundim të procedurës së verifikimit pasurisë dhe figurës së z. Gerti Shani, kandidati për këshilltar ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR